

RAPORT

**MONITORIMI I PROCESIT TË
DECENTRALIZIMIT, SITUATËS SË
SIGURISË DHE SUNDIMIT TË LIGJIT
NË VERI TË KOSOVËS**

FDH KOSOVË

PËRBMAJTJA

Përmbledhje	6
1. Implementimi i procesit të decentralizimit në veri të Kosovës	12
2. Situata e sigurisë në veri të Kosovës	19
3. Sundimi i ligjit	27
4. Institutionet paralele në veri të Kosovës	30
5. Sfidat kryesore që ndikojnë në integrimin e veriut	34
Rekomandimet	40
ANNEX 1. Tryeza e rrumbullakët: Implementimi i procesit të decentralizimit në veri të Kosovës - sfidat dhe mundësitë”	41

PËRMBLEDHJE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Monitorimi i procesit të decentralizimit në Veri të Kosovës” dhe është përkrahur nga Catholic Committee Against Hunger and for Development (CCFD).

Pas publikimit të raportit: “*Decentralizimi një proces sfidues*”, në fund të vitit 2011, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë), gjatë vitit 2012, ka vazhduar me monitorimin e procesit të decentralizimit në veri të Kosovës të situatë së përgjithshme të sigurisë, të sundimit të ligjit, të funksionimit të gjykatave dhe të rolit të mediave.

Qëllimi i këtij projekti është që të paraqesë situatën e përgjithshme në Veri të Kosovës: (Mitrovicë/Mitrovica, Leposaviq/Leposavič, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Zvečan/Zvečan), të nxjerrë rekomandime, të avokojë te autoritetet lokale, qendrore dhe ndërkombëtare për vendosjen e rendit dhe ligjit në këtë pjesë të Kosovës si dhe të promovojë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën politike dhe sociale.

Për përgatitjen e këtij raporti FDH Kosovë ka zhvilluar intervista kualitative me qytetarë të komunave Leposaviq/Leposavič, Zvečan/Zvečan, Zubin Potok/Zubin Potok, dhe në veri dhe jug të Mitrovicës/Mitrovica. FDH Kosovë ka realizuar intervista me zyrtarë të institucioneve lokale, me përfaqësues të institucioneve paralele serbe. që funksionojnë në këtë pjesë të Kosovës, me zyrtarë të nivelit qendror, me organizata jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, FDH Kosovë ka analizuar të dhënat nga mediat, raportet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, qofshin ato qeveritare apo jo-qeveritare. Në përgjithësi, FDH Kosovë ka realizuar 129 intervista, prej të cilave katër intervista me zyrtarë komunalë, dy intervista me zyrtarë të nivelit qendror, dy intervista me zyrtarë ndërkombëtar dhe 121 intervista me qytetarë.

Procesi i decentralizimit në nivel vendi ka filluar me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, më 15 qershor të vitit 2008. Kushtetuta, kryesisht, është hartuar mbi “*Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës*”¹ të ish-presidentit Martti Ahtisari, plan ky, që trajton mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare në Kosovë.

Integrimi i Veriut të Kosovës, edhe pas 13 vitesh nga përfundimi i luftës, mbetet sfidë kryesore e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare prezente në Kosovë.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt të vitit 2008, situata në Veri të Kosovës është përkeqësuar. Shpallja e pavarësisë së Kosovës është përcjellë me djegien e pikave kufitare 1 dhe 31 nga ekstremistët serbë, me pengimin e funksionimit të gjykatave që ka rezultuar edhe me largimin e tyre.

Situata e brishtë në veri të Kosovës ka ndikuar në ngritje të tensioneve dhe të pasigurisë edhe në pjesë tjera të vendit, të banuara nga qytetarë të komunitetit serb, duke vështirësuar edhe më tej integrimin e këtij komuniteti në jetën institucionale të Kosovës.

Në mënyrë që të jetësohet Plani gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës në Veri, në verën e vitit 2012, me vendim të Qeverisë së Kosovës është themeluar Zyra Administrative për Veri të Mitrovicës². Para themelimit të Zyrës Administrative, i vetmi institucion, i cili ofronte shërbime për qytetarët dhe punonte në implementimin e Planit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës dhe për krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve në Veri të Kosovës, ishte Ekipi Përgatitor për Decentralizim në veri të Mitrovicës. Puna e ekipit përgatitor për decentralizim ishte nën mbikëqyrjen e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN)³ deri më 10 shtator të vitit 2012, kur edhe ka përfunduar misioni i kësaj zyre, në mbikëqyrjen e zbatimit të Propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës. Ekipi përgatitor për decentralizim ka realizuar disa projekte: ngritjen e disa

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli 3, neni 57.1

2 Qeveria e Republikës së Kosovës, vendimi Nr.01/75, me datë 23 maj 2012

3 <http://www.ico-kos.org/?id=61>

parqeve, riparime në shërbimet e ujësjellësit dhe projekte tjera infrastrukturore. Me përpjekjet modeste të ekipit përgatitor dhe institucioneve tjera nuk është arritur krijimi i kushteve për themelimin e komunës së Mitrovicës Veriore. Ndërsa shumë larg duket krijimi i kushteve për organizimin e zgjedhjeve në tri komunat tjera Leposaviq/Leposavić, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Zvečan/Zvečan. Ekipi përgatitor ka realizuar disa projekte infrastrukturore në Mitrovicën Veriore, mirëpo tri komunat tjera në Veri të Kosovës janë lënë anash. Institucionet e Republikës së Kosovës kanë dështuar në shtrirjen e aktiviteteve në komunat e lartpërmendura.

Zyra administrative për Veri të Mitrovicës ende nuk është plotësisht funksionale. Pas përzgjedhjes së personelit, prej 52 zyrtarëve, zyra ka filluar me ofrimin e disa shërbimeve publike duke hedhur hapat e parë drejt fillimit të realizimit të Planit të veprimit për decentralizim⁴. Mirëpo, kjo duket e vështirë ngase që nga miratimi i Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, i cili përcakton kufijtë dhe financat lokale⁵, deri më sot nuk është zbatuar në Veri të Kosovës, duke krijuar një boshllëk të përfaqësimit të qytetarëve, që jetojnë në këto komuna. Sipas FDH Kosovë, ekzistojnë disa faktorë që kanë pamundësuar realizimin e procesit të decentralizimit në Veri të Kosovës; mungesa e një plani politik të bashkërenditur nga ana e përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në shtrirjen e autoritetit shtetëror në këtë pjesë të vendit, informimi i pamjaftueshëm i qytetarëve në lidhje me përfitimet që sjellë procesi i decentralizimit dhe më e rëndësishmja – prezenca e strukturave paralele të Republikës së Serbisë, në veçanti strukturat e sigurisë dhe drejtësisë.

FDH Kosovë beson se zgjidhja më e mirë për Veriun e Kosovës është Plani i ish-presidentit Ahtisari, ngase ky plan parasheh krijimin e ambientit më të favorshëm për ofrimin e shërbimeve më efikase për qytetarët lokal si dhe rritjen e nivelit të vendimmarrjes politike.

4 <http://mapl.rks-gov.net/Main-menu/Legjislacioni/Plani-i-veprimit-për-decentralizim-2010-2011.aspx>

5 Ligji NR. 03/L-040, http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=147&Itemid=56&lang=sq

FDH Kosovë vlerëson se opsioni i ofruar me Planin gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës e që parasheh procesin e decentralizimit në veri të Kosovës, nuk është konsumuar ende dhe se institucionet vendore dhe ndërkombëtare në bisedimet politike në mes të Prishtinës dhe Beogradit nuk do duhej të trajtonin modele të tjera të rregullimit administrativ dhe politik. Andaj, institucionet vendore dhe ndërkombëtare duhet të përkushtohen më shumë në promovimin e procesit të decentralizimit nëpërmjet: informimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve mbi rëndësinë e procesit të decentralizimit, zhbërjen e strukturave paralele me ndikim në drejtësi dhe siguri si dhe integrimin e sektorit të arsimit dhe shëndetësisë në kuadër të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Institucionet e Republikës së Kosovës janë zotuar publikisht në zbatimin e Planit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës për Veriun e vendit. Themelimi i zyrës administrative për veri të Mitrovicës/Mitrovica, jep shpresa që kjo të realizohet në praktikë. Mbajtja e zgjedhjeve në tri komunat veriore dhe krijimi i komunës së Mitrovicës/Mitrovica Veriore mbetet ende larg realizimit, ngaqë qytetarët lokal serbë ende kanë qëndrim kundërshtues karshi integritit në sistemin juridik të Kosovës.

Drejtësia dhe siguria mbeten sfidat kryesore të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe misioneve ndërkombëtare, në veçanti të EULEX-it dhe KFOR-it. Nga shkurti i vitit 2008 në veri të Kosovës nuk funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë; prokuroria dhe gjykata e qarkut, gjykata dhe prokuroria komunale si dhe gjykata për kundërvajtje. Momentalisht, këto gjykata janë të vendosura në objektin e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn dhe për shkak të mungesës së hapësirës adekuate bëhet i pamundshëm funksionimi i gjyqësorit. Gjykata e Qarkut në veri të Mitrovicës/Mitrovica ka një personel prej vetëm gjashtë gjykatësve dhe dy prokurorëve ndërkombëtar të EULEX-it, të cilët funksionojnë me kapacitete të kufizuara. Nga kjo situatë e krijuar, banorëve të dy anëve të Mitrovicës iu është mohuar qasja në organet e drejtësisë dhe zgjidhja e rasteve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm kohor⁶.

6 Konventa evropiane për të drejtat e njeriut, neni 6

Në ndërkohë në pjesën veriore të Kosovës kanë vazhduar punën institucionet paralele të drejtësisë, të cilat kryesisht kryejnë funksionet e gjykatës komunale dhe asaj për kundërvajtje, duke zbatuar ligjet e Republikës së Serbisë.

Sipas Policisë së Kosovës numri i incidenteve me motive etnike në Rajonin e Mitrovicës, nga janari deri në shtator të vitit 2012, është 14⁷. Të gjitha incidentet, për të cilat FDH Kosovë ka kryer hulumtimet e nevojshme, qofshin ato të motivuara etnikisht apo jo, rezulton se asnjëra nuk është zgjidhur nga organet kompetente. Moszgjidhja e rasteve ndikon negativisht në përceptimin e opinionit publik e në veçanti të pakicave kombëtare mbi efikasitetin e organeve të ndjekjes dhe drejtësisë.

Shqetësuese mbetet prezenca e strukturave paralele të sigurisë të Republikës së Serbisë në Veri të Kosovës, të cilat pengojnë funksionimin e jetës normale të qytetarëve. Institucionet e Republikës së Kosovës nuk ushtrojnë pushtetin në komunat në veri të vendit. Ato kryesisht kontrollohen nga institucionet paralele të Serbisë, të cilat organizojnë jetën publike dhe institucionale. Në Veri të Kosovës funksionojnë institucionet paralele të edukimit, institucionet paralele të shëndetësisë, institucionet paralele të drejtësisë, institucionet paralele për kulturë dhe sport, institucionet paralele të post-telekomit dhe energjetikës, institucione paralele të qeverisjes lokale, institucionet paralele të sigurisë, institucionet paralele financiare dhe institucionet paralele të transportit.

Situata e përgjithshme e sigurisë në Veri të Kosovës mbetet e paqëndrueshme. Funksionimi i shtetit lidhet me efikasitetin e policisë, prokurorisë, gjykatave, doganave si dhe funksionimin e autoriteteve legjitime lokale. Boshllëku institucional ka krijuar mundësi për veprime kriminale, tregëti ilegale dhe kontrabandë të papenguar. Në këtë mënyrë grupet kriminale kanë rritur ndikimin e tyre ndaj banorëve lokal, duke i shfrytëzuar ata me qëllim të përfitimeve materiale.

7 Policia e Kosovës, Zyra për planifikim operacional, DRP Mitrovicë, 12.10.2012

Një ndër brengat kryesore të qytetarëve në Veri të Kosovës është ekonomia e dobët dhe shkalla e lartë e papunësisë. Mungesa e vendeve të punës, ndikimi i politikës lokale në punësim dhe mungesa e një strategjie për zhvillim ekonomik në nivel nacional dhe lokal janë vetëm disa nga faktorët që reflektojnë në uljen e nivelit të mirëqenies sociale të qytetarëve të Veriut të Kosovës.

FDH Kosovë ka intervistuar pjesëtarë të të gjitha bashkësive etnike, që jetojnë në veri të vendit, duke kërkuar nga ta që të tregojnë shqetësimet kryesore që i preokupojnë. Serbët, shqiptarët, boshnjakët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit pajtohen se situata ekonomike dhe niveli i papunësisë mbeten faktorë shqetësues për të gjithë, përderisa sundimi i rendit dhe ligjit shihet si garanci që të përmirësohet mirëqenia e tyre. FDH Kosovë vlerëson se duhet angazhim më i madh dhe më konkret nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës në vendosjen e rendit dhe të ligjit, i cili është sine qua non për zhvillim ekonomik.

Roli i mediave në pasqyrimin e situatës në Veri të Kosovës është më se i rëndësishëm. Banorët lokalë serbë informohen nga mediat lokale në Veri dhe mediat nga Serbia, të cilat jo rrallëherë keqinformojnë publikun. Raste të tilla vërehen gjatë raportimeve të incidenteve, të cilat paraqiten si të motivuara etnikisht, duke mos pritur rezultatet nga hetimet zyrtare. Raportimi i tillë rritë nivelin e frikës dhe nxitë urrejtjen ndëretnike duke implikuar indirekt edhe pjesën tjetër të Kosovës.

1. IMPLEMENTIMI I PROCESIT TË DECENTRALIZIMIT NË VERI TË KOSOVËS

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, në qershor të vitit 2008, fillon zyrtarisht procesi i decentralizimit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është përpiluar mbi bazën e *“Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës”*⁸.

Qeveria e Kosovës paraprakisht ka prezantuar një strategji për decentralizimin, e cila ka hyrë në fuqi me vendimin e datës 03.04.2008⁹, duke themeluar Grupin Ndërmnistror për Decentralizim (GND), i kryesuar nga ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, si trup përgjegjës qeveritar për bashkërendimin e politikave dhe veprimeve për themelimin e Komunave të reja dhe implementimin e decentralizimit në Republikën e Kosovës. Grupi Ndërmnistror për Decentralizim (GND) ka vepruar në bazë të Planit të veprimit për decentralizim 2008-2010, fillimisht, dhe më pas 2010-2011¹⁰. Edhe pse procesi i decentralizimit nuk ka arritur ndonjë progres që vlen të përmendet në veri të Kosovës, në gusht të vitit 2012, Grupi Ndërmnistror për Decentralizim ka mbajtur takimin përmbyllës duke ia kaluar kompetencat e veta Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës Administrative për Veri të Mitrovicës.

Sipas ligjit, procesi i decentralizimit parashih implementimin e reformave kryesore administrative dhe territoriale, të përforcojë statusin dhe kapacitetet e personelit në nivel lokal, të përcaktojë qartazi funksionet dhe burimet në nivele të ndryshme të qeverisjes si dhe të promovojë transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje duke promovuar dhe mbrojtur të drejtat e qytetarëve¹¹.

Pas zgjedhjeve të vitit 2009, gjatë procesit të decentralizimit, janë themeluar disa nga komunitatet me shumicë serbe si: komuna e Graçanicës/Gračanica, komuna e Ranillugut/Ranilug, komuna e Klllokotit-Verbovc/Klokot-Verbovac dhe zgjerimi i komunës së Novobërdës/Novo Brdo. Edhe pse të gjitha strategjitë dhe planet e veprimit të Qeverisë së Kosovës në vete parashohin mbajtjen e zgjedhjeve edhe në tri komunitatet veriore (Leposaviqit/Leposavić, Zubin Potokut/Zubin Potok dhe Zveçanit/Zvečan), një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Qeveria e Kosovës ka dështuar në zbatimin e strategjisë dhe krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve.

8 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kapitulli 3, neni 57.1

9 Qeveria e Republikës së Kosovës, vendimi nr 04/14, data 03.04.2008

10 <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/c367ecf5-34ab-41f9-b019-79879435071c/Plani-i-Veprimit-per-decentralizim-2010-2011.aspx>

11 http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=147&Itemid=56&lang=sq

“Në pjesën tjetër të Kosovës decentralizimi është treguar i suksesshëm, veçanërisht në komunitat e themeluara Kllokot-Verbovc/Klokot - Verbovac, Ranillug/Ranilug dhe Graçanicë/Gračanica, të cilat kanë evidentuar 100% rritje në pjesëmarrje e qytetarëve në zgjedhjet lokale, krahasuar me shkallën e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhjet e mëhershme, para zbatimit të decentralizimit¹²”.

Decentralizimi në Veri të Kosovës mbetet njëra ndër proceset më të vështira për Kosovën e pas-konfliktit, për vendosjen e autoritetit institucional dhe integrimin e komuniteteve etnike.

Përderisa gjatë vitit 2009 janë themeluar komunitat e lartpërmendura, për arsye të ndryshme dhe të rrethanave më specifike në Veri të Kosovës, tek në vitin 2010 është krijuar ekipi përgatitor për decentralizim në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Vlen të theksohet që fokusi kryesor i ekipit përgatitor për decentralizim ishte Mitrovica e Veriut dhe jo komunitat tjera veriore. Nga qytetarët, në Mitrovicën Veriore, është vërejtur prezenca dhe puna e Ekipit Përgatitor, mirëpo në tri komunitat tjera veriore (Leposaviq/Leposavić, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Zvečan/Zvečan) prezenca e institucioneve të Republikës së Kosovës nuk është vënë re fare.

Ekipi përgatitor për decentralizim në Veri nuk ka arritur të shënojë ndonjë rezultat të theksuar në realizimin e projekteve për shkak të prezencës së fuqishme të strukturave paralele, të financuara nga Beogradi, si dhe ndikimit që kanë grupet e ndryshme të interesit, e të cilët kanë keqpërdorë qytetarët lokal në interes të përfitimeve personale.

“Veriu është tregim në vete. Këtu politikanët dhe kriminelët përfitojnë, ndërsa banorët janë në humbje. Banorët duhet të vetëdijeshohen dhe të organizohen për kushte më të mira dhe jo të jenë pre e politikës dhe kriminelëve. Me këtë situatë banorët e Leposaviqit/Leposavić mbesin pa perspektivë për të ardhmen e tyre. Kjo gjendje nuk duhet të vazhdojë ngaqë nuk na shpie askund”.

Intervistë e FDH Kosovë, M.K, banore serbe

Leposaviq/Leposavić, më 08.10.2012

Gjatë realizimit të projekteve Ekipi Përgatitor për Decentralizim në Mitrovicën Veriore nuk ka mundur t'i shfrytëzojë mbishkrimet ku do të tregoheshin iniciuesi, punëkryesi dhe përkrahësi i projektit, ngase këto mbishkrime demoloreshin apo shkatërroheshin nga individë apo grupe të ndryshme kriminale. Për më shumë

¹² Besnik Tahiri, Tryeza e organizuar nga FDH Kosovë 05.07.2012 me temën “Decentralizimi në Veri të Kosovës, Sfidat dhe mundësitë”

vendosja e mbishkrimeve do të rrezikonte në tërësi realizimin e këtyre projekteve dhe për këtë arsye shumë banorë të veriut të Mitrovicës/ Mitrovica nuk janë informuar mbi realizimin e projekteve të iniciuara nga ekipi përgatitor për decentralizim.

Qytetarët serbë të Veriut të Kosovës, të cilët përbejnë shumicën, janë pak të informuar mbi të mirat dhe mundësitë që ofron procesi i decentralizimit dhe në të shumtën e rasteve ata janë të keqinformuar për përmbajtjen e tij. Këtë fakt e mbështesim në intervistat të cilat FDH Kosovë i ka realizuar gjatë kësaj periudhe me qytetarët e Veriut, gjë të cilën e konfirmon edhe raporti i publikuar nga Zyra Civile Ndërkombëtare - Mitrovicë (ZCN), në prill të vitit 2012.¹³

“Neve na thuhet se procesi i decentralizimit do të sjellë më shumë të drejta për pakicat që jetojnë në Kosovë. Mirëpo, nga ajo që unë kam kuptuar, pas pranimit të decentralizimit nga ana jonë do të pasojë okupimi dhe menaxhimi nga ana e Prishtinës”

Intervistë e FDH Kosovë, A.N. banor serb

Zubin Potok/Zubin Potok, 06.09.2012

“Ne, të cilët jetojmë në Leposaviq/Leposavić, vlerësojmë se decentralizimi nuk është në të mirën tonë. Shumica e banorëve më me dëshirë do të qëndronin si pjesë e Serbisë, siç edhe jemi tani. Nëse ne do të prananim decentralizimin atëherë Prishtina mund të bëjë çfarë të dojë me ne”.

Intervistë e FDH Kosovë, O.V. banor serb

Leposaviq/Leposavić, më 19.06.2012

“Nuk kam shumë njohuri mbi procesin e decentralizimit, di vetëm që ka të bëjë me Veriun. Për më shumë nuk mund të tregoj sepse asnjëherë nuk jam informuar nga dikush në lidhje me domethënien e tij.”

Intervistë e FDH Kosovë V.M. qytetare serbe

Mitrovicë/Mitrovica Veriore, 14.05.2012

Qeveria e Kosovës, në takimin e rregullt të datës 23.05.2012, ka miratuar vendimin për themelimin e Zyrës administrative për Mitrovicën/Mitrovica Veriore¹⁴. Kjo zyrë ka filluar punën në korrik të vitit 2012. Shefe e kësaj zyre është përzgjedhur Adrijana Hodzic. Është bërë zgjedhja e personelit, me gjithsejtë 52 zyrtarë, prej të cilëve: 38

13 Raporti “Mysafirë në shtëpinë tonë : Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit dhe Komuniteti serb në Kosovën veriore, Prill 2012.

14 Qeveria e Republikës së Kosovës, vendimi Nr.01/75, me datë 23 Maj 2012

zyrtarë të nacionalitetit serb, tetë shqiptarë, pesë boshnjakë dhe një i kombësisë turke. Kjo zyrë ka themeluar 7 drejtori: drejtorinë e administratës së përgjithshme, drejtorinë e financave dhe zhvillimit ekonomik, drejtorinë e shërbimeve publike, investimeve në infrastrukturë dhe inspeksionit, drejtorinë e komuniteteve lokale dhe marrëdhëniet me publikun, drejtorinë e mirëqenies sociale dhe shëndetit, drejtorinë e planifikimit urban, kadastër dhe inspeksionit dhe drejtorinë e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit.

Zyra administrative për Mitrovicë/Mitrovica Veriore (ZAMV) do të punojë, si një mekanizëm i përkohshëm administrativ, deri në krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve dhe themelimin e komunës së re të Mitrovicës/Mitrovica Veriore. Baza ligjore mbi funksionimin e ZAMV-së është Ligji mbi vetëqeverisjen lokale¹⁵.

Puna e ZAMV-së po has në vështirësi si rezultat i mosgatishmërisë së komunitetit lokal në Veri për t'u integruar në institucionet e Kosovës.

“Nuk na duhet decentralizimi. Institucionet e Kosovës s’kanë çka të kërkojnë këtu. Kjo është Serbi. Ne respektojmë Kushtetutën e Republikës së Serbisë dhe çdo gjë funksionon në kuadër të ligjeve serbe.”

Intervistë e FDH Kosovë, O.S. banor serb

Zubin Potok/Zubin Potok, 21.05.2012

“Mbajtja e zgjedhjeve të lira është e vështirë për shkak të mungesës së vullnetit të qytetarëve atje për t'u integruar në institucionet e Kosovës. Mbajtjes së zgjedhjeve të lira në zonat në veri të Kosovës do t'u hapet rruga vetëm me shtimin e vullnetit të serbëve për zhvillimin e këtij procesi dhe me rritjen e numrit të partive politike serbe të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”¹⁶.

“Përkrahje nuk kemi nga Qeveria e Kosovës, nuk mendoj se duhet të kemi sepse kjo pjesë i takon Serbisë.”

Intervistë e FDH Kosovë, M.M. banor serbë

Leposaviq/Leposavić, 05.08.2012

Indikator tjetër për mosgatishmërinë e integritit në institucionet e Republikës së Kosovës është edhe bojkoti nga ana e banorëve të Veriut regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, i cili ishte organizuar nga Ministria e Shërbimeve

¹⁵ Ligji për vetëqeverisjen lokale, Ligji NR. 03/L - 040

¹⁶ <http://www.telegrafi.com/lajme/mungon-vullneti-per-integrim-2-25044.html>

Publike dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, në prill të vitit 2011¹⁷. Sipas ueb-faqes së Zyrës Administrative për Mitrovicën/Mitrovica Veriore, në Mitrovicën/Mitrovica, Veriore jetojnë rreth 20,000 banorë, 17,000 prej të cilëve janë serbë të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër, 3,000, shqiptarë, boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptianë dhe një komunitet i vogël goran. Sipas të dhënave jozyrtare në tërë Veriun jetojnë rreth 40,000 banorë, shumica prej tyre i takojnë nacionalitetit serb¹⁸.

“Decentralizimi është proces, i cili ka të bëjë me qytetarët. Gati askund në botë nuk ka rezistencë ndaj këtij procesi. Fatkeqësisht decentralizimi i Veriut është politizuar e ne po orvatemi që të eliminojmë këtë faktor, t’u sqarojmë qytetarëve se çka do të fitojnë me këtë proces dhe sa i rëndësishëm është ky proces për ta”¹⁹.

Gjatë periudhës kohore qershor-shtator të vitit 2012, tre zyrtarëve të ZAMV-së u janë djegur veturat para shtëpive të tyre. Sipas tyre, arsyeja e sulmeve është frikësimi i punëtorëve dhe presioni ndaj tyre për t’u larguar nga puna.

“Kemi shumë provokime psikologjike dhe sulme fizike ndaj zyrtarëve të Zyrës Administrative. Siguria e zyrtarëve mbetet shumë shqetësuese, përkundër rreziqeve motivi për punë është shumë i madh, ngase ata besojnë që janë duke dhënë kontribut në përmirësimin e jetës së komunitetit prej nga vijnë.”

Dušan Milosavljević / Dushan Millosavljeviq

zëvendës shef i ZAMV, intervistë e FDH Kosovë, 19.09.2012

Cak i sulmeve ishte vetë zëvendësshefi i ZAMV-së Dušan Milosavljević /Dushan Millosavljeviq. Me 07 dhjetor të vitit 2012, rreth orës 23:30, në afërsi të lokalit “Ambienti”, në veri të Mitrovicës/Mitrovica, një person i maskuar ka shtënë me armë zjarri në drejtim të Dušan Milosavljević /Dushan Milosavljeviq dhe tre zyrtarëve tjerë të ZAMV-s. Nga të shtënat Dušan Milosavljević /Dushan Milosavljeviq, është plagosur në këmbë. Në një intervistë për gazetën Jeta në Kosovë Dušan Milosavljević /Dushan Milosavljeviq ka deklaruar:

“Kur kemi dalë prej lokalit në rrugë, e kemi parë një person, i veshur më të zeza dhe maskë në fytyrë. Ai kishte pasur një ‘Scorpion’ në dorë edhe nga rreth 20 metra ka nisur të qëllojë në drejtim tonin. Janë shkrepur 7-8 krisma, që nuk janë dëgjuar shumë, pasi arma duket se ka qenë profesionale”²⁰

¹⁷ <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=1,40>,

¹⁸ <https://kk.rks-gov.net/mnao/thecity.aspx>,

¹⁹ Intervistë e Ministrit Slobodan Petrovic, dhënë për M-Magazina, Shtator 2011

²⁰ <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,4060>

Përkundër vështirësive të shumta, ZAMV-ja ka filluar me ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Sipas të dhënave të siguruar nga FDH Kosovë, nga 23 korriku i vitit 2012 deri më 16 tetor të vitit 2012, Zyrës i janë drejtuar në total 1331 qytetarë me kërkesa të ndryshme, kryesisht kërkesa individuale. Nga ky numër 57-përqind kanë qenë qytetarë serbë, 32-përqind shqiptarë, 7-përqind boshnjakë, turq 2-përqind, dhe të tjerë 2-përqind. Nga muaji tetor i vitit 2012 ZAMV-ja ka filluar edhe me dhënie të dokumenteve personale, letërnjoftimeve, patentshoferëve, të dokumente pronësore, me regjistrimin e automjeteve dhe një serë shërbimesh tjera.²¹

Qytetarëve në Veri u mungojnë njohuri themelore mbi konceptin dhe modelin e decentralizimit dhe rezultatet e prekshme që do rrjedhin nga ky proces. Një anketë e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN), në vitin 2011, ku kanë marrë pjesë 800 qytetarë, që jetojnë në Veri (me 500 respondentë nga Mitrovica e Veriut), tregon që mbizotëron një keqkuptim i thellë në lidhje me procesin dhe parimet e decentralizimit. Në pyetjen se çfarë kuptojnë me termin “decentralizim”, 33-përqind e serbëve të Kosovës kanë zgjedhur të përgjigjen që “decentralizimin e kuptojnë që Prishtina do të qeverisë” dhe 27-përqind e tyre e kuptojnë “decentralizimin si diçka që ka të bëjë me Planin e Ahtisaarit”. Në fakt, vetëm 12-përqind të serbëve të anketuar e kuptojnë rëndësinë e procesit të decentralizimit²².

“Mendoj se në përgjithësi Plani Ahtisari ofron mundësi të mira për Serbët në Kosovë, mirëpo problem mbetet implementimi në praktikë. Komuniteti serb, e në veçanti banorët e Veriut janë kundër çdo plani apo strategjie që parasheh integrimin në institucionet e Prishtinës. Mund të marrim shembull barrikatadat si përgjigje të banorëve të veriut të Kosovës kundër vendosjes së institucioneve, në këtë rast doganat e Kosovës. Ne duhet të përballemi me faktet edhe nëse dikush nuk dëshiron t'i pranojë ato. Dialogu është mundësi e mirë, mirëpo në këtë dialog duhet të përfshihen edhe përfaqësuesit politik nga Veriu. Nëse i referohemi Ekipit Përgatitor dhe tani Zyrës Administrative, më duhet të them se zyrtarët nuk gëzojnë besimin e qytetarëve dhe puna e tyre është e destinuar të dështojë”.

Intervistë e FDH Kosovë, S.I., aktivist i shoqërisë civile

Mitrovicë/Mitrovica Veriore, më 03.04.2012

²¹ Intervistë e FDH Kosovë, ZAMV, 17.10.2012

²² Forum 2015, raporti “Mëngjesi një ditë pas: Jeta pa mbikëqyrje, gusht 2012, fq 24

“Kjo pjesë nuk ka kurrfarë lidhje me Kosovën, nuk na duhet decentralizimi, ne i takojmë Serbisë dhe shtetit serb.”

Intervistë e FDH Kosovë, M.Lj. banor serb

Zvečan/Zvečan, me 08.06.2012

Themelimi i komunës së Mitrovicës/Mitrovica Veriore dhe mbajtja e zgjedhjeve në tre komunat tjera veriore, mbetet ende shumë larg realizimit. Synimet e Qeverisë së Kosovës për ta integruar pjesën veriore të vendit po has në rezistencën e serbëve të atjeshëm lokal duke vështirësuar shtrirjen e autoritetit shtetëror të Kosovës.

2. SITUATA E SIGURISË NË VERI TË KOSOVËS

Qeveria e Kosovës duke mos arritur të shtrijë autoritetin e saj në Veri të Kosovës ka mundësuar forcimin e strukturave paralele, të cilat po vazhdojnë funksionimin duke u bazuar në ligjet e Republikës së Serbisë. Janë krijuar struktura paralele të policisë, gjyqësisë, arsimit, shëndetësisë, si dhe kuvende komunale paralele në Veri të Kosovës. Këto struktura paralele janë të vetmet, të cilat funksionojnë dhe udhëheqin me jetën publike në veri.

Për funksionimin e strukturave paralele të sigurisë janë në dijeni EULEX-i dhe autoritetet kosovare. Ato e konsiderojnë si mjaft shqetësuese këtë situatë dhe se institucionet janë duke e trajtuar si çështje të rëndësisë së veçantë.

“Sa i përket strukturave serbe të sigurisë, ne dhe të gjithë të tjerët jemi në dijeni për praninë e tyre në Veri. Kjo është një çështje shqetësuese, dhe është duke u trajtuar në nivelet më të larta”²³.

“Roli i tyre gjithmonë ka qenë negativ. Strukturat paralele të sigurisë janë përgjegjëse për vepra të ndryshme penale, frikësimit dhe veprave të tjera, të cilat në shumë situata kanë marrë karakter politik. Ne jemi të vetëdijshëm se ato nuk kanë një shtrirje administrative të kryerjes së detyrave të tyre. Por gjithsesi janë prezente dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre ilegalisht në territorin e Republikës së Kosovës, kryesisht në Veri”

Intervistë e FDH Kosovë, B.H. zëdhënës i Policisë së Kosovës në

Mitrovicë/Mitrovica, 13.06.2012

Viti 2012 është karakterizuar me incidente të shumta, prej të cilave disa besohet të jenë të motivuara etnikisht. Sipas Policisë së Kosovës, Drejtorisë Rajonale në Mitrovicë/Mitrovica numri i incidenteve të lajmëruara ndëretnike në periudhën janar - shtator 2012 është 14²⁴, për disa nga të cilat FDH Kosovë ka realizuar intervista me palët e dëmtuara.

“Ishim duke ecur te ura, e cila bashkon Jugun me lagjen “Tre soliterat”, kur kemi vërejtur një grup prej 8-10 personash. Në momentin kur na dëgjuan që flasim shqip disa prej tyre na bllokuan rrugën. Ata filluan të na godasin dhe nga këto goditje na

23 Blerim Krasniqi zëdhënës i EULEX-t, intervistë e dhënë për Radion Evropa, 01.11.2012

24 Policia e Kosovës, Zyra për planifikim operacional, DRP Mitrovicë, 12.10.2012

shkaktuan lëndime trupore. Policia e Kosovës ka dalë në vendin e ngjarjes gjashtë orë pas incidentit. Sa herë që ndodhë ndonjë incident ka vonesa të reagimit nga Policia e Kosovës, edhe pse për shkak të situatës policia duhet të jetë e pranishme në këtë lagje, e cila është etnikisht e përzier”.

Intervistë e FDH Kosovë, F.J. banor shqiptar

Mitrovicë/Mitrovica me 02.05.2012

Me 2 nëntor të vitit 2012, në veri të Mitrovicës, përkatësisht në lagjen e Boshnjakëve, dy të rinj shqiptarë (B.S dhe A.G) janë sulmuar nga një grup i personave të panjohur. Sipas viktimave sulmi, nga i cili kanë marrë lëndime trupore, ishte i motivuar etnikisht.

“Janë shfaqur para nesh përnjëherë dhe kanë filluar të na sulmojnë me grushte dhe duke na sharë e ofenduar në baza nacionale”, ka thënë B.S, duke shtuar se ata persona nuk i kishte parë asnjëherë më parë. Sipas tij, dyshohet se sulmuesit janë nga vise tjera dhe jo qytetarë të Mitrovicës/Mitrovica”²⁵.

Sulme të motivuara etnikisht kanë ndodhur edhe në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Sulmi ndaj Vlladimir Denoviqit/Vladimir Denovič, më 8 prill të vitit 2012²⁶, nga fshati Suhodoll i Mitrovicës/Mitrovica dhe sulmi ndaj murgut Millorad Bullajiq/Milorad Bulajič, më 23 qershor të vitit 2012, në jug të Mitrovicës.

“Sulmi ndaj murgut në jug të qytetit, tregon se nuk ka siguri për ne serbët dhe s’kemi çfarë të kërkojmë andej. S’kemi çfarë presim më shumë kur një i pafajshëm sulmohet, merr lëndime dhe askush nuk e parandalon”.

Intervistë e FDH Kosovë, N.P. banor serb

Mitrovicë/Mitrovica veriore, 15.06.2012

“Disa ditë para incidentit, kam vizituar disa herë komunën e Mitrovicës/Mitrovica për nxjerrjen e dokumenteve për pronën, të cilën e kam në Lagjen e Boshnjakëve. Nuk kam pasur probleme deri më 23 qershor, kur jam sulmuar fizikisht nga dy persona. Isha duke shkuar në drejtim të komunës, më janë afruar dy persona shqiptarë dhe kanë filluar të më godasin. Njëri prej tyre kishte shufër hekuri dhe nga goditjet e marra në kokë dhe trup kisha gjakderdhje. Më pas një kalimtar i rastit më ka dërguar në spital në Veri ku kam qëndruar për 5 ditë”.

25 <http://www.balkanweb.com/kosova/2686/sulmohen-dy-shqiptare-ne-veri-te-mitrovices-108288.html>

26 Kumtesë për medie, FDH Kosovë” Të zbardhen rastet e incidenteve ndëretnike”, 10.04.2012, <http://www.koha.net/index2.php?page=1,13,95028>

Intervistë e FDH Kosovë, M.B. murg serb

Mitrovicë/Mitrovica veriore, 23.08.2012

Incidenti më i rëndë dhe me pasoja humbje jete ishte ai i 8 prillit të vitit 2012. Si pasojë e një shpërthimi në lagjen “Tre rrokaqiejt”, në banesën e tij, ka humbur jetën Selver Haradinaj, 38 - vjeçar, kurse lëndime trupore kanë marrë tre fëmijët e tij²⁷. Edhe pse deri në përgatitjen e këtij raporti institucionet përgjegjëse nuk kanë dalë me ndonjë raport zyrtar mbi motivet e mundshme të këtij incidenti, çështja është ngritur në nivel të lartë publik, ku me kërkesën e mbi 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me 18 prill të vitit 2012, është mbajtur seancë e jashtëzakonshme lidhur me gjendjen në veri të Kosovës.

Ky incident fillimisht është prezantuar si incident i motivuar etnikisht, ndërsa ministri i Punëve të Brendëshme, Bajram Rexhepi, në intervistën dhënë në emisionin RUBIKON të KTV-së, më 24 tetor të vitit 2012, ka deklaruar se “vrasja e Selver Haradinajt nuk është vrasje me motive etnike”²⁸. Në seancën e jashtëzakonshme të 18 prillit kryeministri i Republikës së Kosovës gjithashtu u ka bërë thirrje partive politike dhe qytetarëve të mos paragjykojnë motivin pa u kryer hetimi i plotë. Duke akuzuar partitë tjera opozitare se janë duke e përdorur situatën e krijuar për nxitje të dhunës dhe urrejtjes ndëretnike, Kryeministri kishte deklaruar:

“Nuk mund të pajtohem me disa zëra opozitarë që drejtuan gishtin kundër një komuniteti të caktuar në Kosovë se ka gisht në vrasje. Kjo nxitje e dhunës ndëretnike, nxitje e tensioneve ndër-qytetare dhe pretendimi për të përsëritur atë që nuk do të duhej përsëritur në Kosovë - viti 2004, është një pretendim i papërgjegjshëm”²⁹.

FDH Kosovë vlerëson se ky incident do të mund të evitohet nëse Policia e Kosovës do të vendoste një pikë statike në lagjen e “Tre rrokaqiejve”, kërkesë kjo që gjithashtu është bërë nga banorët e lagjes. Një kërkesë e tillë është bërë në shkurt të vitit 2012 nga përfaqësuesi i lagjes Adem Tolaj, gjatë takimit të Komitetit për vlerësimin e sigurisë në komunën e Mitrovicës/Mitrovica³⁰, e cila është anashkaluar nga organet komunale dhe Policia e Kosovës.

“Që nga paslufta ballafaqohemi me kërcënime për jetën tonë. Disa javë më parë një grup prej tre personash të maskuar, me shufra hekuri kanë sulmuar një mik timin duke i shkaktuar dëmtime të rënda trupore. Policia e Kosovës nuk ofron kurrfarë sigurie, ata

27 Ibid

28 <http://www.kohavision.net/video/rubikon/4881/>

29 Transkripti i seancës së jashtëzakonshme lidhur me gjendjen në Veri, fjalimi i Kryeministrit Hashim Thaqi, 18 Prill 2012

30 <http://www.m-magazine.org/sq/Kosove/Banort-tek-Tre-rrokaqiet-krkojn-pik-statike-t-policis-1290>

ndihen të pafuqishëm dhe kanë frikë nga grupet kriminale këtu në Veri. Shpërthimi i eksplozivit ka ndodhë në të njëjtën ndërtesë, në të cilën unë jetoj. Kemi kërkuar nga Policia e Kosovës një pikë statike të kontrollit dhe ende asgjë nuk është bërë në atë drejtim. Poashtu, më duhet të them që sulmet ndaj shqiptarëve në Veri injorohen nga ana e Policisë së Kosovës”.

Intervistë e FDH Kosovë, I.SH. banor shqiptar i lagjes

“Tre rrokaqiejt” me 09.04.2012

Një ditë pas shpërthimit, me 9 prill të vitit 2012, me urdhër të drejtorit rajonal të Policisë së Kosovës në Mitrovicë/Mitrovica, është vendosur një pikë statike policore në lagjen “Tre rrokaqiejt”. Mirëpo shumë shpejt pas vendosjes së pikës statike është lëshuar sirena, e cila shfrytëzohet për mbledhjen e qytetarëve dhe strukturave paralele kriminale. Grupet ekstremiste, sipas Policisë së Kosovës rreth 200 persona, për rreth 30 minuta kanë demoluar kabinën e Policisë së Kosovës, duke i larguar policët kosovarë nga aty.

Me qëllim të shtimit të masave të sigurisë, nga data 10.04.2012, dy pikat statike janë përforcuar me zyrtarë policorë në lagjen “Tre rrokaqiejt” dhe në lagjen “Kodra e Minatorëve” si dhe ka patrullime policore në këmbë³¹. Përkundër kësaj, banorët shqiptarë nuk janë të kënaqur me sigurinë e ofruar nga institucionet e Kosovës, respektivisht nga Policia e Kosovës.

“Shumë prej banorëve të Lagjes “Kodra e Minatorëve” kanë shitur trojet e tyre dhe janë larguar si rezultat i mungesës së sigurisë. Kur kemi probleme Policia e Kosovës nuk guxon të intervenojë, gjë që për ne paraqet problem të madh. Në afërsi është një patrullë e policisë mirëpo në rast të eskalimit të situatës ata largohen dhe ne mbesim të vetëm”.

Intervistë e FDH Kosovë, G.H. banor shqiptar

Përfaqësuesi i lagjes “Kodra e Minatorëve”, 01.10.2012

“Asgjë nuk ka ndryshuar, sa herë që vi në punë, më duhet të kontrolloj mos ndoshta dikush ka vendosur ndonjë bombë. Nuk kemi kurrfarë sigurie. Si mund të presësh siguri kur policët kanë frikë, apo ndonjëherë kundërshtojnë të veprojnë për arsye nga më të ndryshme. Unë personalisht ballafaqohem me kërcënime pothuajse çdo ditë. Rasti i fundit ishte kërcënimi nga ana e një banori serb, sepse në dyqanin tim pagesa bëhet me euro dhe jo me dinar, duke më bërë me dije se këtu jam në Serbi”

³¹ Ministri i punëve të brendshme, z.Bajram Rexhepi, Seanca e jashtëzakonshme në kuvendin e Kosovës, 18.04.2012

Intervistë e FDH Kosovë, N.N. banor shqiptar

Lagja “Tre rrokaqiejt”, 13.08.2012

“Kemi probleme të shpeshta. Nuk kemi lëvizje të lirë. Sulmohemi fizikisht dhe jemi dëshmitarë të incidenteve të ndryshme. Mundësia për incidente është më evidente gjatë organizimit të protestave nga ana e politikanëve serbë për të kundërshtuar Qeverinë e Kosovës, EULEX-in apo edhe veprimet e KFOR-it”.

Intervistë e FDH Kosovë, J.D. banor serb

Mitrovicë/Mitrovica me 04.06.2012

Incidentet e kësaj natyre kanë mundur të kenë për pasojë edhe ngritjen e tensioneve ndëretnike edhe në pjesët tjera të Kosovës. Më 23.05.2012 në fshatin Drenoc/Drenovac komuna e Klinës/Klina , ishte djegur shtëpia e Millovan Radosavleviq/Milovan Radosavljevič, një banor serb i kthyer në këtë fshat³².

Mbishkrimet kërcënuese në kishat ortodokse Serbe në Manastirin e Deçanit/Dečani, në fshatin Reçan/Rečane, në Shtërpce/Štrpce dhe në oborrin e Kishës në Prizren/Prizren, janë disa nga incidentet që kanë ndodhur gjatë muajit prill të vitit 2012 pas tensioneve dhe sulmeve në veri të Kosovës³³.

Viktimë e sulmeve kriminale janë edhe banorët serbë të qytetit të Mitrovicës/Mitrovica veriore. Me 13.08.2012, persona të panjohur kanë vendosur eksploziv, në restorantin “Tiha Noc”, me pronar serb R.J. Për fat të mirë në kohën e incidentit në lokal nuk ka pasur mysafirë dhe ishin shkaktuar vetëm dëme materiale.

“Ditën e incidentit jam kthyer nga pushimet verore. Në fillim nuk kam vërejtur se diçka pazakonshme po ndodhë. Lokali im është i njohur si vend ku ka mysafirë të nacionaliteteve të ndryshme, si dhe marrëdhëniet e mija personale me fqinjët janë shumë të mira dhe asnjëherë nuk kam pasur probleme apo mosmarrëveshje. Eksplodimi ka ndodhur rreth orës 23:30, nga i cili janë shkaktuar disa dëme materiale. Policia ishte në vendin e ngjarjes dhe sipas informatave që i kam, hetimet janë duke vazhduar”.

Intervistë e FDH Kosovë, R.J. banor serb

Mitrovicë /Mitrovica veriore, 14.08.2012

32 Intervistë e FDH Kosovë, me 23.05.2012, M.R banor serb në fshatin Drenoc/Drenovac, komuna Klinë/Klina
33 <http://www.radiokim.net/vesti/napadi-na-crkvenu-imovinu.html>,

“Ky qytet është i njohur për tensione ndërretnike. Nevojitet shumë pak që të vijë deri te eskalimi i situatës e në veçanti në lagjet etnikisht të përziera”.

Intervistë e FDH Kosovë, D.Z. banor serb

Mitrovicë/Mitrovica veriore, 15.05.2012

Krahasuar me publikimin e FDH Kosovë në janar të vitit 2009 mbi situatën e sigurisë në veri të Mitrovicës/Mitrovica³⁴, vlerësohet se situata e sigurisë jo vetëm që nuk është përmirësuar por ka degraduar edhe më shumë. Institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare janë arsyetuar se politika ditore është ajo që po pengon normalizimin e situatës në Veri të vendit.

• SHQIPTARËT E FSHATRAVE VERIORE TË KOSOVËS

Në komunat veriore të Kosovës: Leposaviq/Leposavić, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Zvečan/Zvečan, komuniteti shqiptar është pakicë. Banorët e fshatrave me shumicë shqiptare Çabër/Cabar (Zubin Potok), Lipë/Lipa, Boletini/Boljetin dhe Zhazhë/Žaža (Zvečan/Zvečan), Koshtovë/Košutovo, Bistricë/Bistrica dhe Cerajë/Ceranje (Leposaviq/Leposavić), nuk gëzojnë liri të plotë të lëvizjes. Këto vendbanime të banuara me shqiptarë janë vise të largëta malore dhe janë ndër pjesët më të varfra e të izoluara në Veri të Kosovës.

Banorët shqiptarë të fshatrave Bistricë/Bistrica, Koshtovë/Košutovo dhe Cerajë/Ceranje ballafaqohen me probleme të shumta. Rruga, e cila lidh këto fshatra, është e pashtruar dhe tejetë e vështirë për qarkullim të automjeteve. Banorët përveç që ndihen të lënë anash nga institucionet shtetërore, provokohen dhe rrezikohen nga grupet ekstremiste serbe.

“Pas aksionit të 25 korrikut nga ROSU, gjendja e sigurisë është përkeqësuar. Fshatrat Koshtovë, Bistricë dhe Cerajë, janë fshatra me shumicë shqiptare dhe janë të largëta e të izoluara. Disa herë jemi kërcënuar nga radikalët serbë. Nuk më kujtohet data e saktë, me ç’rast një grup i serbëve në motoçikleta dhe të armatosur na kërcënonin në fshat, duke gjuajtur me armë zjarri në ajër”.

Intervistë e FDH Kosovë, A.M. banor shqiptar

Koshtovë/ Košutovo, më 13.06.2012

Në Bistricë është vetëm një shkollë fillore dhe një shtëpi shëndeti, të cilat shërbejnë për tri fshatrat me shumicë shqiptare. Shkolla fillore “Kadri Bistrica” numëron

34 Raport i FDH Kosovë “Situata e sigurisë në Mitrovicë/Mitrovica”, Dhjetor 2008 - Janar 2009

gjithsejtë 27 nxënës, të cilët vijojnë mësimin nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Shtëpia e shëndetit në këtë fshat ka dy teknikë infermierë, të cilët përveç punës së tyre, punojnë edhe si shofer të autoambulancës. Gjatë vitit 2012 shtëpia e shëndetit nuk ka pasur buxhet për regjistrim të automjetit dhe sigurimin e derivateve. Ndër problemet të përditshme në këtë pjesë të Kosovës mbeten transporti, edukimi dhe kujdesi shëndetësor.

“Transporti organizohet tri herë në ditë, në përcjellje të Policisë së Kosovës. Për vitin 2012 pagesa për transport të nxënësve dhe mësimit është siguruar nga komuna e Mitrovicës/Mitrovica, mirëpo nuk kemi përgjigje nëse do ta kemi të siguruar edhe për vitin e ardhshëm. Nuk kemi materiale bazë për mbarëvajtjen e mësimit. Nuk kemi fonde për të pajisur shkollën me mjete të nevojshme për mësim të mirëfillt”.

Intervistë e FDH Kosovë, F.Sh. drejtor i shkollës fillore

“Kadri Bistrica”, 13.06.2012

“Nuk kemi shërbime të mira shëndetësore. Pas 25 korrikut të vitit 2012 kemi mbetur edhe pa mjek. Momentalisht kemi përkuqdesje vetëm nga dy infermierë, të cilët duhet ta kryejnë edhe punën e mjekut. Kemi mungesë të barnave esenciale. Shtëpia e shëndetit në Mitrovicë na ka ndihmuar me furnizim edhe pse nuk janë të obliguar, sepse fshatrat tona i takojnë komunës së Leposaviqit/Leposaviç”.

Intervistë e FDH Kosovë, N.A, banor shqiptar

Bistricë/Bistrica, 13.06.2012

“Nuk kemi buxhet për mirëmbajtjen, regjistrimin e as për derivate për auto-ambulancën, e cila do të duhej të shfrytëzohej për nevojat e pacientëve. Në rastet kur qytetarët kanë nevojë duhet të gjejnë mënyra të ndryshme për të siguruar pagesën për derivate nga financat personale”.

Intervistë e FDH Kosovë, M.M. teknik infermier banor shqiptar

Bistricë/Bistrica, 13.06.2012

Nga viti 2005, në fshatin Bistricë/Bistrica funksionon edhe zyra e gjendjes civile në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. Që nga ajo kohë deri me datë 13.06.2012, pranë kësaj zyre janë pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës mbi 3.000 qytetarë. Aplikimet kryesisht janë bërë nga ana e banorëve serbë. Nga janari deri në qershor të vitit 2012 ka pasur rreth 300 aplikime, nga të cilat përqindja më e madhe e aplikuesve i përkasin nacionalitetit serb.

“Për komunën e Leposaviqit/Leposavić e vetmja zyrë e gjendjes civile e Republikës se Kosovës është kjo ne fshatin Bisticë/Bistrica. Deri më sot nuk kemi pasur ndonjë problem me aplikuesit, të cilët në të shumtën e rasteve janë serbë dhe të cilët vijnë nga komuna e Leposaviqit/Leposavić”.

Intervistë e FDH Kosovë, N.A. zyrtar i gjendjes civile

Bisticë/Bistrica, 13.06.2012

Shqiptarët e këtyre viseve, përveç me kufizim të lëvizjes së lirë janë me të ardhura të ulëta dhe sigurojnë mbijetesën nga bujqësia. Qasja në shërbime publike mbetet problem kyç, veçanërisht në kujdesin shëndetësor dhe atë të edukimit.

3. SUNDIMI I LIGJIT

Sundimi i ligjit në Veri të Kosovës vazhdon të jetë çështje brengosëse. Gjykata në Mitrovicë vazhdon të përbëhet vetëm nga gjyqtarë e prokurorë të EULEX-it, si dhe të funksionojë me kapacitet të kufizuar, përderisa rastet civile kanë mbetur pezull që nga ndalimi i punës së Gjykatës në mars të vitit 2008. Gjykata e Qarkut në veri të Mitrovicës/Mitrovica ka një personel prej vetëm gjashtë gjykatësve dhe dy prokurorëve ndërkombëtarë të EULEX-it. Gjykata dhe prokuroria e qarkut, gjykata dhe prokuroria komunale si dhe gjykata për kundërvajtje në Mitrovicë/Mitrovica nuk funksionojnë që prej 20 shkurtit të vitit 2008. Këto institucione për momentin janë të vendosura në objektin e gjykatës në Vushtrri/Vučitrn, objekt ky, i cili nuk plotëson kushtet elementare për funksionim të mirëfilltë. Hapësira në të cilën punojnë gjykatësit dhe prokurorët është e pamjaftueshme për të pranuar palë dhe për të zhvilluar hetime të nevojshme. Me largimin e gjykatësve lokal nga objekti në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, kanë mbetur mbi 3.000 lëndë, në të cilat edhe sot gjykatat vendore nuk kanë qasje³⁵. Komuniteti serb disa herë nëpërmjet të protestave kanë penguar kthimin e gjykatësve dhe prokurorëve lokal në gjykatë.

“Me mosfunksionimin adekuat të gjykatave shkelen të drejtat elementare të qytetarëve. Numri i lëndëve po rritet dita-ditës dhe këto lëndë nuk po zgjidhen. Si rezultat i mungesës së kushteve elementare për punë dhe mungesës së objektit nuk po dëmtohen vetëm qytetarët e Veriut por edhe ata të Jugut të Mitrovicës/Mitrovica. Gjykatësit dhe prokurorët sillen nëpër korridore ngase nuk kemi zyre për ta. Në mungesë të hapësirës për punë, me rast të pranimit të palës nga një gjykatës apo prokuror, pjesa tjetër e personelit detyrohen të dalë jashtë”

**Intervistë e FDH Kosovë, Xh.A, kryetar i Gjykatës së Qarku
Mitrovicë/Mitrovica, 30.10.2012**

“Kam probleme që të zhvilloj hetimet e nevojshme në mungesë të hapësirës. Mundësia ime si prokuror që të vizitoj vendngjarjen në Veri nuk ekziston. Personalisht gjatë punës në terren i jam ekspozuar rrezikut për jetë nga ndërhyrja e strukturave paralele të sigurisë në vendngjarje”

35 Intervistë e FDH Kosovë, XH.A, kryetar i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë/Mitrovica

Intervistë e FDH Kosovë, XH.B, prokuror i Qarkut

Mitrovicë/Mitrovica, 30.10.2012

Në veri të Kosovës funksionojnë strukturat paralele të sistemit të drejtësisë. Gjykatat kryejnë funksionet e gjykatës për kundërvajtje dhe asaj komunale dhe ato merren kryesisht me konteste civile, siç janë certifikatat e shkurorëzimit, trashëgimisë etj, duke zbatuar ligjet e Republikës së Serbisë³⁶.

Intervenimi i Njësisë Speciale (ROSU), i urdhëruar nga Qeveria e Kosovës, më 25 korrik të vitit 2011, për t'i zbatuar masat e reciprocitetit tregëtar me Serbinë, ka ngritur tensionet në veri të Kosovës. Qëllimi i Qeverisë së Kosovës ishte edhe ndryshimi statusquo-së së krijuar pas shpalljes së pavarësisë dhe tentim për vendosjen e autoritetit të Prishtinës në Veri. Gjithsesi, ky intervenim ka radikalizuar situatën e sigurisë duke forcuar edhe më shumë ndikimin e udhëheqësve ekstremistë serbë në Veri.

Intervenimi i Njësisë Speciale (ROSU), ka mobilizuar grupet ekstremiste në Veri, të cilat kanë shfrytëzuar intervenimin e Njësisë Speciale për t'i manipuluar banorët lokal në bllokimin e rrugëve në tërë territorin e pjesës veriore të Kosovës. Barrikatat në rrugët e komunave veriore kanë vështirësuar qarkullimin e njerëzve, mallrave dhe patrullimin e automjeteve të EULEX-it, KFOR-it dhe Policisë së Kosovës.

“Të gjithë kemi të drejtë në jetë dhe lëvizje të lirë, por kjo nuk vlen për ne. Ekziston frikë kur duhet të udhëtojmë në drejtim të Prishtinës apo edhe në vendet tjera në jug të Kosovës. Frikësohemi se dikush mund të na sulmojë fizikisht vetëm se s’jemi shqiptarë”.

Intervistë e FDH Kosovë, D.K. banore serbe

Zveçan/Zvečan, më 04.10.2012

“Nuk e kemi mundësinë e lëvizjes së lirë. Banorëve të Mitrovicës u mohohet kjo e drejtë elementare. Barrikatat e kanë vështirësuar edhe më shumë lirinë e lëvizjes. Shqiptarët, të cilët jetojnë në veri janë barrikaduar nëpër shtëpitë e tyre”

Intervistë e FDH Kosovë, B.S. banor shqiptar

Mitrovicë/Mitrovica, 03.04.2012

Mungesa e lirisë së lëvizjes me vendosjen e barrikadave ka vështirësuar punën e Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica. Prokuroria po hasë në vështirësi për të kryer hetimet e nevojshme mbi zbardhjen e rrethanave të vrasjes së policit Enver

36 Intervista nga FDH Kosovë, shtator 2012.

Zymeri, vrasje, e cila ka ndodhur gjatë intervenimit të Njësisë Speciale (ROSU), me 25 korrik të vitit 2011. Pengesa të ngjashme ka edhe për hetimet mbi incidentet tjera, që kanë ndodhur në veri të Kosovës³⁷.

FDH Kosovë vlerëson se situata e sigurisë është e paqëndrueshme dhe me mundësi përkeqësimi. Politikanët lokalë të veriut refuzojnë çdo marrëveshje të arritur në bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, duke i konsideruar këto marrëveshje si tradhti të Beogradit ndaj qytetarëve të tyre në veri të Kosovës.

Mosdëgjueshmëria e politikanëve lokalë ndaj pushtetit në Beograd është dëshmuar edhe me organizimin e zgjedhjeve lokale serbe në maj të vitit 2012, përkundër thirrjeve të Beogradit që zgjedhjet lokale të mos mbahen³⁸.

Në pikën kufitare në Jarinjë/Jarinje, më 10 dhjetor të vitit 2012 ka filluar zbatimi i pilotprojektit për menaxhimin e integruar të vendkalimeve kufitare (IBM)³⁹. Serbët në veri të Kosovës paralajmërojnë që do ta kundërshtojnë këtë marrëveshje me të gjitha mjetet duke shfrytëzuar edhe më tej rrugët alternative⁴⁰. Nga ky qëndrim i politikanëve serbë të veriut mund të ketë trazira të reja dhe realizimi i marrëveshjeve të arritura në Bruksel ndërmjet palëve do të rrezikohet në praktikë.

Grupet kriminale, që veprojnë në veri të Republikës së Kosovës i koordinojnë veprimet e tyre me strukturat paralele komunale, MUP-in serb dhe liderët politikë komunalë. Grupet kriminale, të cilat veprojnë, e të cilat paraqesin rrezik për qytetarët dhe institucionet e Kosovë dhe ato ndërkombëtare janë: SNP 1389, Car Lazar, Naši, dhe Obraz⁴¹.

“Ndihe m më i sigurt gjatë ditës, por në mbrëmje çdo gjë mund të më ndodhë mua dhe banorëve tjerë. Nuk mund të parashikoj se çfarë mund të na ndodhë çdo moment, nëse ndokush do i vë flakën automobilin tim, mos ndoshta do të më largojnë apo t’ia ven flakën shtëpisë sime. Nuk besoj që kjo klasë politike kriminale do të ndryshojë diçka për të mirë. Nuk e kanë bërë këtë deri më tani pse të besoj se do e ndryshojnë në të ardhmen. Institucionet që veprojnë në V-eri bashkëpunojnë ngushtë me grupet kriminale për interesa të tyre personale, nuk brengosen për sigurinë tonë”.

Intervistë e FDH Kosovë, V.B. banor serb, refugjat nga Istogu

Zubin Potok/Zubin Potok, 08.03.2012

37 Intervistë e kryeprokurorit të Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë me 25.07.2012, Radio Evropa e Lirë

38 <http://www.koha.net/?page=1,13,96389>

39 <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/62639/menaxhimi-i-integruar-i-kufirit-nis-me-10-dhjetor/>

40 Ibid

41 Gazeta “Koha Ditore”, 16.11.2012

4. INSTITUCIONET PARALELE NË VERI TË KOSOVËS

Të vetmet institucione, të cilat janë funksionale në Veri të Kosovës, përjashtuar EULEX-in dhe KFOR-in me veprimtari të kufizuar, janë institucionet paralele të mbështetura nga Republika e Serbisë. Në këtë pjesë të Kosovës funksionojnë: institucionet paralele të edukimit, të shëndetësisë, të drejtësisë, institucionet paralele për kulturë dhe sport, institucionet paralele të post-telekomit dhe energjetikës, institucione paralele të qeverisjes lokale, institucionet paralele të sigurisë, institucionet paralele financiare dhe institucionet paralele të transportit.

“Edukimi, komunat, posta dhe gjykatat, funksionojnë sipas ligjeve të Republikës së Serbisë. Targat i kam nga Serbia, kam dëgjuar se duhet t'i zëvendësoj me targat e Kosovës mirëpo nuk më konvenon, sepse shumë shpesh udhëtoj për në Serbi. Me targat KS nuk mund të udhëtoj në Serbi dhe nuk jam i interesuar të ndahem nga komunikimi me shtetin tim”.

Intervistë e FDH Kosovë, A.O. banor serb

Leposaviq/Leposavić, 20.06.2012

“Nuk kemi asnjë kontakt me institucionet e Prishtinës, bashkëpunojmë dhe jemi në kontakt të përhershëm me Qeverinë e Serbisë.”

Intervistë e FDH Kosovë, D.M., kryetar i komunës paralele

Zvečan/Zvečan, 02.05.2012

Në kuadër të Universitetit Paralel të Prishtinës/Pristina, në veri të Mitrovicës/Mitrovica, funksionojnë 10 fakultete: Fakulteti Ekonomik(Mitrovicë/Mitrovica Veriore), Fakulteti i Mjekësisë (Mitrovicë/Mitrovica Veriore), Fakulteti i Drejtësisë (Mitrovicë/Mitrovica Veriore), Fakulteti i Shkencave Matematikore (Mitrovicë/Mitrovica Veriore), Fakulteti i Shkencave Teknike (Mitrovicë/Mitrovica Veriore), Fakulteti i Filozofik (Mitrovicë/Mitrovica Veriore), Fakulteti i Arteve (Zvečan/Zvečan), Fakulteti i Edukimit (Leposaviq/Leposavić), Fakulteti i Edukimit Fizik (Leposaviq/Leposavić) dhe Fakulteti i Agrikulturës (Lešak).⁴²

Universiteti paralel i Prishtinës/Priština, numëron gjithsejtë 746 profesorë dhe

42 <http://www.pr.ac.rs/en/home/about-the-university/university-today>, 30.10.2012

asistentë, rreth 350 punëtorë tjerë administrativë dhe momentalisht numri i studentëve është mbi 10.000, në të gjitha nivelet akademike⁴³. Rektor i Universitetit është prof. dr Zdravko Vitošević.

Sipas të dhënave nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë dhe Zyra për Kosovë dhe Metohi e Qeverisë së Serbisë, numri i nxënësve në institucionet paralele parashkollore, fillore dhe të mesme për vitin shkollor 2012/2013 është 25.000 nxënës në gjithë territorin e Kosovës nga të cilët rreth 10.000 nxënës të shkollave të mesme⁴⁴.

Në veri të Kosovës, funksionojnë këto shkolla fillore dhe të mesme:

- 1) Shkollat fillore: “Branko Radicevic”, “Desanka Maksimovic”, “Veljko Banashevic”, “Dositej Obradovic”, “Vlado Cetkovic”, “Zarija Jovanovic” .
- 2) Shkolla e mesme Teknike “Mihailo Petrovic Alas”, Mitrovicë/Mitrovica Veriore,
- 3) Shkolla e mesme e Mjekësisë, Mitrovicë/Mitrovica Veriore,
- 4) Gjinnazi, Mitrovicë/Mitrovica Veriore,
- 5) Shkolla Ekonomike dhe Tregtare, Mitrovicë/Mitrovica Veriore,
- 6) Shkolla e mesme Teknike, Zveçan/Zvečan,
- 7) Shkolla e mesme “Gligorije Bozovic”, Zubin Potok/Zubin Potok,
- 8) Shkolla e mesme “Nikola Tesla”, Leposaviq/Leposavić,
- 9) Shkolla e lartë e Bujqësisë, Lesak.

FDH Kosovë, gjatë punës në terren ka tentuar të sigurojë numrin e saktë të personelit dhe nxënësve në këto shkolla, por për fat të keq nuk ka marrë përgjigje nga institucionet paralele të edukimit. Në raportin e publikuar nga Zyra e koordinаторit për Veri e Qeverisë së Kosovës në maj të vitit 2011 figurojnë këto të dhëna: në shkollën fillore “*Branko Radiçevic*” janë regjistruar 560 nxënës, të punësuar 53, nga të cilat 35 janë mësues. Shkollat e tjera kanë rreth 350 nxënës dhe 70 të punësuar, të cilët janë të paguar direkt nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë⁴⁵. Sipas hulumtimit të FDH Kosovë këto të dhëna janë të përafërta edhe për vitin shkollor 2012/2013.

Institucionet paralele të shëndetësisë të cilat operojnë në veri të Kosovës janë këto:

- Spitali i qytetit në Mitrovicë/Mitrovica
- Qendra e mjekësisë në Mitrovicë/Mitrovica
- Qendra e mjekësisë në Zubin Potok/Zubin Potok

43 Ibid

44 <http://www.kim.gov.rs/sr/vesti/item/104-pocela-skolska-godina-na-kosovu-i-metohiji-na-severu-protesti-djaka>, 07.11.2012

45 Raport i Zyrës së koordinаторit për Veri të Mitrovicës, Maj 2011

- Qendra e mjekësisë në Leposaviq/Leposavić
- Qendra farmaceutike me zyre në Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Leposaviq/Leposavić

Banorët e veriut të Kosovës janë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga Qendrat e mjekësisë, të cilat funksionojnë në komunat e tyre.

“Shëndetësia është në gjendje shumë të mirë, kemi shërbime falas, të cilat janë të mirëseardhura për ne. Me librezat shëndetësore kemi mundësi për shërim dhe në rastet më të rënda na dërgojnë në spitalin ushtarak në Beograd”.

Intervistë e FDH Kosovë, M.K. banore serbe

Leposaviq/Leposavić, me 08.10.2012

“Banorët e veriut janë të kënaqur me institucionet serbe, siç janë edukimi, shëndetësia, shërbimet sociale, shërbimi postar, energjia dhe të tjera. Nga kjo kuptohet se nuk kemi nevojë për institucione tjera sepse jemi të kënaqur me këto që i kemi”.

Intervistë e FDH Kosovë, S.I. banor serb

Mitrovicë/Mitrovica Veriore, me 03.04.2012

Përderisa institucionet paralele të edukimit dhe shëndetësisë ofrojnë mundësi dhe shërbime për qytetarët, problematike dhe pengesë serioze për integrimin e qytetarëve të Veriut në jetën publike e sociale mbesin institucionet paralele të sigurisë, të qeverisjes lokale dhe të drejtësisë, të cilat paraqiten më poshtë në këtë raport.

Që nga vitit 1999, në veri të Kosovës kanë funksionuar strukturat paralele të sigurisë. Ndikimi dhe veprimtaria e tyre është intensifikuar edhe më shumë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Organizimi dhe financimi i shërbimeve të sigurisë është direkt i lidhur me Qeverinë e Republikës së Serbisë. Në raportin e publikuar nga Zyra e koordinatorit për veri⁴⁶, janë dhënë fakte të dokumentuara, të cilat tregojnë mbështetjen e këtyre strukturave nga Beogradi, duke shkelur marrëveshjen e Kumanovës⁴⁷, e cila ndalon prezencën dhe funksionimin e institucioneve të sigurisë. Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, Mbrojtja Civile, BIA, Zbulimi Ushtarak (VBA), Sektori i Policisë së Sigurisë Publike vazhdojnë me aktivitetet e tyre në veri të Kosovës. Shumë nga anëtarët e Institucioneve paralele të sigurisë, janë edhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës.

46 Raport i Zyrës së koordinatorit për Veri “Mbi strukturat paralele të sërabisë në veri”, Maj 2011, fq 41-51

47 Marrëveshja e Kumanovës, pika 1.3.

Sipas të përditshmes Koha Ditore, autoritetet shtetërore të sigurisë kanë informata se në Veri vepron rreth 500 pjesëtarë të MPB-së, të cilët janë të armatosur dhe të rekrutuar në Kralevo/Krlevë të Serbisë, e të cilëve u prinë Đorđe Dragović/Gjorgje Dragović. Mbrojtja Civile ka rreth 254 rekrutë të parë nga Radisav Janičijević/Radisav Janičijević. Shërbimi sekret BIA e udhëhequr nga Savo Milenković/Savo Millenković dhe VBA, që për përgjegjës në Kosovë ka Jovica Llazareviqin/Jovica Lazarević.⁴⁸

Institucionet paralele të Drejtësisë, të cilat vepron në veri të Kosovës janë: Gjykata Komunale Mitrovicë/Mitrovica, Gjykata për Kundërvajtje Mitrovicë/Mitrovica, Prokuroria Komunale e Mitrovicës/Mitrovica, Gjykata Komunale e Leposaviqit/Leposavić, Gjykata për Kundërvajtje Leposaviq/Leposavić dhe Gjykata e Lartë Mitrovicë/Mitrovica, me seli në Zvečan/Zvečan.

Në nëntor të vitit 2012, janë parë disa persona me uniforma të mbrojtjes civile duke patrulluar në veri të Kosovës mbi urën e Ibrit, te Spitali në Veri të Mitrovicës, tek Gjykatat dhe në fshatin Rudar/Rudare. Sipas filmimeve të Televizionit Top Channel⁴⁹ dhe asaj që kishin parë banorët lokal, dhjetëra persona me uniforma të kaltra në të cilat shkruante në gjuhën serbe, alfabetin cirilik dhe në gjuhën angleze “Mbrojtja Civile” patrullonin në pjesën veriore të Mitrovicës.

FDH Kosovë në bazë të observimeve të saj dhe intervistave me qytetarë vlerëson se sistemi paralel i arsimit dhe shëndetësisë, për dallim nga ai i sigurisë dhe drejtësisë nuk kanë luajtur rol negativ në jetën e qytetarëve, por kanë përmbushur nevojat minimale të domosdoshme qytetare. FDH Kosovë mendon se integrimi i institucioneve paralele të shëndetësisë dhe të arsimit në kuadër të sistemit të edukimit dhe shëndetësisë të Republikës së Kosovës do ishte i mundshëm dhe nga kjo do përfitonte komuniteti në Veri, por edhe institucionet e vendit. Investimet kapitale nga ana e republikës së Kosovës në këto institucione do të kishin ndikim substancial në përmirësimin e shërbimeve që ofrojnë këto institucione. Në këtë mënyrë do krijohet sistemi unik i shëndetësisë dhe arsimit në tërë territorin e Kosovës.

Nga ana tjetër ekzistenca e strukturave paralele të Drejtësisë dhe Sigurisë krijon një situatë, e cila në asnjë mënyrë nuk mund të sigurojë jetë normale për banorët e veriut të Kosovës. Për më tepër kjo situatë krijon pasiguri dhe huti tek qytetarët. Shuarja e këtyre institucioneve paralele është parakushti kryesor për normalizimin e situatës së sigurisë në veriun e Kosovës, andaj FDH Kosovë kërkon nga BE që të iniciojë këtë çështje në bisedimet politike në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

48 Besnik Krasniqi, Gazeta “Koha Ditore”, 16.11.2012, ballina dhe faqe 3

49 <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=245485#.UJkReb--rcc>

5. SFIDAT KRYESORE QË NDIKOJNË NE INTEGRIMIN E VERIUT

Qytetarët serbë të veriut të Kosovës janë larg integrimit në jetën politiko – shoqërore të vendit. FDH Kosovë vlerëson se elementi kyç në ndryshimin e kësaj gjendjeje është vullneti politik i Beogradit zyrtar. Ky vullnet mund të ndryshojë gjatë procesit negociator, që zhvillohet në Bruksel, me ç ‘rast të dy palët mundën të tejkalojnë ndasitë në lidhje me problemet jetësore të qytetarëve që do të shpinte drejt një marrëveshjeje politike, rezultat i së cilës do të ishte pranimi i institucioneve të Kosovës nga ana e komunitetit serb në Veri. Vetëm vullneti politik, si i tillë, nuk do të ishte i mjaftueshëm. Me shtrirjen e rendit juridik numri i incidenteve të karakterit ndëretnik do të mund të zvogëlohej dhe të gjitha incidentet do të kishin një trajtim serioz nga ana e organeve të ndjekjes dhe gjyqësisë, gjë që do të forconte kredibilitetin e institucioneve kosovare karshi pakicës serbe dhe rrjedhimisht besueshmërinë e qytetarëve në raport me institucionet.

“Veriu është një problem që duhet të zgjidhet gjatë bisedimeve politike në Bruksel, mirëpo mosbesimi është aq i thellë saqë edhe gjenetikisht do të trashëgohet. Dialogun e shoh si të nevojshëm, por në të duhet të futemi sinqerisht për të zgjidhur probleme e jo pse një gjë të tillë e kërkon dikush”⁵⁰.

Sipas hulumtimeve të FDH Kosovë, qytetarët serb të veriut të Kosovës e shohin me skepticizëm edhe situatën e sigurisë së bashkëkombësve të tyre në pjesën qendrore të Kosovës dhe e përdorin këtë si pretekst në arsyetimin e tyre se siguria mund t’iu rrezikohet në momentin kur Veriu do të integrohej në sistemin kosovar të qeverisjes. E gjithë kjo është më e evidente në momentin kur raportohet ndonjë incident ndëretnik, ku serbët apo pronat e tyre dhunohen. Ekonomia e dobët, papunësia dhe shkalla e lartë e varfërisë në Republikën e Kosovës shton mëdyshjen në përfitimet e mundshme nga procesi i integrimit në institucionet kosovare.

“Si të integrohemi, kur dëgjojmë dhe lexojmë nëpër gazeta se është sulmuar një i kthyer serb në komunën e Gjilanit/Gnjilane, se i është djegur shtëpia një tjetri në Klinë/Klina.”

Intervistë e FDH Kosovë, Z.B. banor serb

Leposaviq/Leposavić, 26.06.2012

“Mjafton përcjellja e RTK-s dhe do ta shihni gjendjen në jug të Kosovës dhe atentatet që bëhen ndaj serbëve. Mund të dëgjoni edhe për ekonominë e dobët dhe mungesën e vendeve të punës për të rinjtë. E njëjta situatë është edhe në Veri, pse duhet të integrohemi në institucionet e Kosovës kur asgjë e mirë nuk na ofrohet por vetëm më keq”.

Intervistë e FDH Kosovë, N.N. banor serb

Zubin Potok/Zubin Potok, 04.09.2012

Kosova nuk ka sistem të vetëm monetar në gjithë territorin e saj. Dinari serb është valutë në përdorim në veri të Kosovës. Qytetarët e pjesës Veriore dhe pjesa dërmuese e bizneseve përdorin dinarin serb si mjet këmbimi. Rënia e numrit të vendeve të punës si pasojë e mosfunksionimit të ndërmarrjeve publike është shqetësimi kryesor për banorët serb në Veri.

“Vlerësoj se qytetit tonë i duhet një plan për zhvillim ekonomik. Me anë të zhvillimit ekonomik do të përmirësohej situata e sigurisë, do të kemi cilësi më të mirë të jetesës dhe do të përmirësohej lëvizja e lirë. Në këtë mënyrë do të angazhoheshim në punët tona dhe nuk do të kishim kohë të merremi me politikë, gjë e cila po na dërgon drejt dështimit dhe izolimit”.

Intervistë e FDH Kosovë, U.R. banor serbë

Leposaviq/Leposavić, 19.07.2012

“Banorët e komunës së Leposaviqit/Leposavić ballafaqohen me shkallë të lartë të papunësisë. Derisa nuk zgjidhet problemi i papunësisë situata e sigurisë dhe e sundimit të ligjit do mbetet e njëjtë”.

Intervistë e FDH Kosovë, Z.V. banor serb

Leposaviq/Leposavić, 12.09.2012

“Për bashkëmoshatarët e mi problemi më i madh është papunësia. Nuk ka kurrfarë perspektive për mua dhe kolegët e mi. Kolegët dhe shoqëria ime planifikojnë largimin për në Serbi apo edhe në drejtim të shteteve tjera perëndimore”.

Intervistë e FDH Kosovë, S.V. studente serbe në

Mitrovicë/Mitrovica Veriore, 05.06.2012

Nepotizmi dhe përkatësia partiake edhe në këtë pjesë të Kosovës, e cila drejtohet nga strukturat paralele, mbeten mundësitë më të mira për gjetjen e një vendi të punës.

“Kemi klasë politike, e cila ndikon dhe kontrollon sistemin e edukimit, shëndetësisë, shërbimeve publike dhe të gjitha fushat tjera. Në veçanti kur flasim për punësim, mënyra më e lehtë që ta fitoni një vend pune është nëse jeni anëtarë i ndonjë partie politike”.

Intervistë e FDH Kosovë, D.O.

Leposaviq/Leposavić, më 10.05.2012

Bizneset, të cilat funksionojnë në veri të Mitrovicës nuk paguajnë tatim dhe as shërbime komunale, ujë apo rrymë. Mungesa e inspektimeve u mundëson pronarëve të biznesit t'i shmangen tatimit dhe të tregtojnë mallra të kontrabanduara dhe me origjinë të dyshimtë, duke rrezikuar shëndetin, mirëqenien e qytetarëve dhe në të njëjtën kohë duke u pasuruar në mënyra joligjore⁵¹. Kontrabanda e mallrave nëpër rrugët alternative nga ana e grupeve kriminale dhe bizneseve të ndryshme ka dëmtuar buxhetet e të dyja shteteve, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

“Serbët e Veriut dhe Shqiptarët e Jjugut punojnë bashkë për kalimin ilegalë të derivateve, gjësendeve tjera ushqimore dhe të tjera mallra, të cilat ne nuk i dimë”

Intervistë e FDH Kosovë, M.K. banor serb

Zvečan/Zvečan, 17.08.2012

Sipas hulumtimeve të Televizionit B92 nga Beogradi, kontrabanda nëpër rrugët alternative buxhetit të Serbisë i ka kushtuar 650.000 euro në ditë. Ndërsa buxheti i Kosovës për dhjetë vitet e fundit, nga kontrabanda në Veri është dëmtuar me mbi 400 milion euro⁵². Sipas informacioneve nga doganat e Kosovës vetëm vlera e mallrave kontrabandë, të kontrolluara nga Zvonko Veselinović/Zvonko Veselinoviq, është 22.330.510 euro, derisa evazioni fiskal është 14,881,367 euro⁵³.

Për të vazhduar me ambientin, i cili mundëson zhvillimin e aktiviteteve të jashtëligjshme, individë dhe grupe kriminale në emër të “patriotizmit” vendosin barrkada në rrugët zyrtare me ndihmën e qytetarëve, të cilët manipulohen pikërisht me kartën e këtij “patriotizmi” dhe shfrytëzojnë rrugët ilegale të kontrabandës me qëllim të përfitimit material. Se ekziston një lloj kohabitacioni në mes të përfaqësuesve politik lokal në Veri dhe të grupeve kriminale, në lidhje me arsyeshmërinë e vendosjes së barrkadave, dëshmojnë qëndrimet politike të liderëve lokalë e që më së miri kuptohet nga deklarata dhënë FDH Kosovës e ashtuquajtura kryetare e Kuvendit Komunal Paralel të Mitrovicës së Veriut:

51 <http://www.b92.net/insajder/video.php>, Shtator 2012

52 Koha Ditore “Mbi 400 milion euro humbje nga kontrabanda në veri”, 25.04.2012

53 Ibid

”Barrikatat nuk janë turp por rezistencë që të mos përsëritet Marsi i vitit 2004 ... serbët janë detyruar t’i ngritin këto barrikada në mënyrë që t’i mbrojnë shtëpitë, fëmijët dhe veten e tyre prej sulmeve nga Jugu”.

Intervistë e FDH Kosovë, L.L. kryetare e Kuvendit Komunal Paralel

Mitrovicë/Mitrovica Veriore, 15.08.20102

FDH Kosovë vlerëson se ky motiv për vendosjen e barrikadave nuk qëndron, sepse shumica e barrikadave janë të vendosura në rrugët e pjesës më veriore të Mitrovicës ku kontakti me shqiptarë është pothuajse joekzistent.

FDH Kosovë vlerëson se në kuadër të angazhimeve të gjithmbarshme për integrimin e kësaj pjese të Kosovës nevojitet një qasje më proaktive dhe e paanshme e mediave në pasqyrimin e situatës. Banorët lokal serbë informohen nga mediumet lokale në veri dhe mediat nga Serbia, të cilat jo rrallë herë propagandojnë dhe keq informojnë publikun. Raste të tilla vërehen gjatë raportimeve të incidenteve, të cilat paraqiten si të motivuara etnikisht, duke anashkaluar hulumtimet, hetimet e nevojshme nga organet përgjegjëse dhe para bërjes publike të gjetjeve nga këto hetime. Raportimi i tillë gjithmonë ndikon në rritjen e frikës dhe nxitjen e urrejtjes ndëretnike nga që indirekt implikon edhe pjesën tjetër të Kosovës.

“Mediat lokale në veri kanë prirje për raportime të njëanshme në dëm të qytetarëve duke mos pasqyruar të vërtetën. Informatat joreale ndikojnë negativisht në mua, por edhe tek banorët tjerë gjithashtu”.

Intervistë e FDH Kosovë, M.O. banor serb

Leposaviq/Leposavić, 11.07.2012

“Mediat lokale zakonisht shfrytëzohen për propagandë politike dhe thirrje për dalje në protesta. Mënyrat e raportimit nga ana e mediave në Veri nxisin nervozë dhe rrisin tensione ndëretnike. Mediat kontribuojnë edhe në ngritjen e ndjenjës nacionaliste me programet e tyre të përditshme”.

Intervistë e FDH Kosovë, J.S. student serb në

Mitrovicë/Mitrovica Veriore, 09.05.2012

Frymën e informimit profesional dhe të paanshëm duhet ta ndjekin edhe mediat në gjuhën shqipe, nga që jo rrallëherë edhe këto të fundit janë tendencioze dhe gjuha e përdorur nuk i ndihmon relaksimit dhe normalizimit të marrëdhënieve ndëretnike.

Gjatë intervistave të realizuara nga FDH Kosovë, shprehet frika që trashëgimia fetare mund t'u merret nga Kosova dhe të "shqiptarizohet", siç shprehen qytetarët.

"Kisha në jug të Mitrovicës është shkatërruar gjatë marsit të vitit 2004 dhe nuk e kam vizituar që nga ajo kohë, por edhe nuk kemi çfarë të vizitojmë, sepse është plotësisht e dëmtuar. Varrezat janë gjithashtu të dëmtuara rëndë. Është shumë e rëndësishme për ne serbët mbrojtja e trashëgimisë fetare".

Intervistë e FDH Kosovë, N.N. banor serb në

Mitrovicë/Mitrovica Veriore, 22.05.2012

Liria e përdorimit të gjuhës serbe dhe identitetit kulturor dhe fetar të tyre, implementimi i ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe mbrojtja e objekteve fetare janë indikatorë që pasqyrojnë mënyrën se si trajtohen komunitetet në Kosovë.

"Bashkëkombësit tanë nga komuna e Graçanicës/Gračanica, tregojnë se Institucionet e Kosovës nuk po i respektojnë ligjet, të cilat do duhej të garantonin dhe mbronin të drejtat tona."

Intervistë e FDH Kosovë, Z.B. banor serb

Leposaviq/Leposavić, 26.06.2012

Liria e lëvizjes mbetet sfidë më vete. Numër i madh i banorëve shqiptarë, që kanë banesa dhe shtëpi në pjesën veriore të Mitrovicës, me vite të tëra janë të privuar nga mundësia e kthimit në pronat e tyre. Së fundmi kjo situatë është rënduar edhe më shumë me vendosjen e barrikadave.

"Për shkak të protestave dhe barrikadave të vendosura nga serbët na pamundësohet kthimi në vendbanimet tona"

Intervistë e FDH Kosovë, G.H. banor shqiptar

përfaqësuesi i lagjes "Kodra e Minatorëve", 01.10.2012

Gjithashtu, edhe pjesëtarët e komunitetit serb e kanë të vështirësuar lëvizjen në anën jugore të Mitrovicës, ku kryesisht ata interesohen për varret e më të dashurve të tyre:

"Vizita në varrezat serbe, të cilat janë të shkatërruara nga shqiptarët në Jug, mund të bëhen vetëm me përcjellje të policisë. Këtë e shoh si presion ndaj nesh. Kisha, e cila është shkatërruar gjatë marsit të vitit 2004, nuk është renovuar. Ky objekt nuk është në gjendje të mirë për t'u mundësuar serbëve kryerjen e ritualeve fetare".

Intervistë e FDH Kosovë, M.K. banor serb

Zveçan/Zvečan, 17.08.2012

Sfidë në lirinë e lëvizjes është edhe mosimplementimi i marrëveshjeve mbi përdorimin e dokumenteve për automjetet e transportit. Vozitësit, që udhëtojnë në veri të Kosovës ballafaqohen me probleme kur bëhet fjalë për pagesën e polisës së sigurimit për aksidentet në trafik, sepse atje zbatohen ligjet e Serbisë, të cilat dallojnë nga ato të Kosovës. Taksistët shqiptarë nuk janë të sigurve në rast të ndonjë aksidenti në pjesën Veriore dhe të gjithë vozitësit tjerë të sigurve në kompanitë kosovare të sigurimit udhëtojnë në Veri pa targa, e në rast aksidenti atyre nuk u mbulohen dëmet e shkaktuara.

“Shfrytëzoj rrugët alternative, sepse nuk ndihem i sigurt të udhëtoj nëpër rrugët kryesore. Nuk posedoj dokumente të Kosovës, nuk posedoj targa të Kosovës, sepse nuk më duhen. Nëse do më nevojiten ndonjëherë do i nxjerr”.

Intervistë e FDH Kosovë, M.R, banor serb

Zubin Potok/Zubin Potok, 04.09.2012

“E rëndësishme është zgjidhja e çështjes së sigurisë. Pa garantim të sigurisë nuk mund të vazhdohet me tej. Nëse nuk garantohet siguria atëherë do kemi problemin e lëvizjes së lirë. Nuk mund të prisni nga unë që të udhëtoj lirshëm në Jug kur nuk ka siguri. Nuk më duhen dokumentet e Kosovës, me të cilat nuk do kem mundësi të udhëtoj lirshëm për në Serbi”.

Intervistë e FDH Kosovë, I.M, banor serb

Zubin Potok/Zubin Potok, 04.09.2012

“Liria e lëvizjes është problem kryesor në Mitrovicë/Mitrovica. Veç jeni në dijeni të ekzistimit të barrikadave gjithandej. Barrikada në urën kryesore sipas meje mund të konsiderohet si kufi, nga e cila cenohet lëvizja e lirë.”

Intervistë e FDH Kosovë, O.D. taksist serb

Mitrovicë/Mitrovica veriore, 05.05.2012

REKOMANDIMET:

- Zyra Administrative për Veriun e Mitrovicës në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), duhet të përgatisin një plan për informimin publik për përmbajtjen e Planit Ahtisaari.
- Qeveria e Kosovës dhe Zyra Administrative për Veriun e Mitrovicës, duhet të punojë në realizimin e projekteve infrastrukturore, nëpër tri komunat tjera veriore: Leposaviq/Leposavić, Zvečan/Zvečan dhe Zubin Potok/Zubin Potok.
- Qeveria e Kosovës të investojë më shumë në fshatrat me shumicë shqiptare në veri të Kosovës: Bistricë, Cerajë dhe Kushtovë. Investimet dhe përmirësimi i ekonomisë në jug të Mitrovicës/Mitrovica dhe në fshatrat me shumicë shqiptare do të ndikojë që serbët e veriut të shohin se cila është oferta.
- Autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës dhe EULEX-i, duhet të punojnë për rivendosjen e sundimit të ligjit në veri të Kosovës dhe kthimin e Gjykatave në veri të Kosovës.
- Qeveria e Kosovës duhet të punojë më shumë në integrimin e minoriteteve, posaçërisht të minoriteti serb në të gjitha institucionet e Kosovës. Duke e bërë të qartë se shteti i Kosovës është i përkushtuar në forcimin e shtetit shumë-etnik dhe se këtë e garanton Plani Ahtisaari dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
- Policia e Kosovës duhet të angazhohet më shumë në zbardhjen e incidenteve të motivuara etnike në veri të Kosovës, por edhe të incidenteve me motive etnike në gjithë territorin e Kosovës.
- Qeveria e Kosovës, duhet të hartojë një plan për zhvillim ekonomik të pjesës veriore të Kosovës dhe hapjen e vendeve të reja të punës.
- Qeveria e Kosovës duhet të garantojë implementimin e ligjeve, që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e pakicave kombëtare.
- Qeveria e Kosovës gjatë bisedimeve politike me Beogradin, duhet të insistojë në kërkesën për shuarjen e strukturave paralele të sigurisë dhe gjyqësisë.
- Në bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të përfshihen edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit politikë të veriut të Kosovës.
- Të monitorohet me vëmendje implementimi i Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare. Në veçanti mbishkrimet e rrugëve dhe institucioneve të jenë me shkrim korrekt pa gabime gjuhësore.
- Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Mitrovicës, duhet t'i rinovojë dhe të ndajnë buxhet për mirëmbajtjen e varrezave serbe në jug të Mitrovicës.

ANNEX 1. TRYEZA E RRUMBULLAKËT: IMPLEMENTIMI I PROCESIT TË DECENTRALIZIMIT NË VERI TË KOSOVËS - SFIDAT DHE MUNDËSITË

Në organizim të Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë), më 5 korrik 2012, në Mitrovicë, u mbajt tryeza e rrumbullakët me temë: *“Implementimi i procesit të decentralizimit në veri të Kosovës - sfidat dhe mundësitë”*. Pjesëmarrësit në këtë tryezë të rrumbullakët ngritën shqetësimet e tyre në lidhje me mbarëvajtjen e procesit të decentralizimit në veri të Kosovës, hapjen e zyrës administrative, sfidat, të cilat i presin institucionet vendore dhe ndërkombëtare, situatën e sigurisë dhe rolin e shoqërisë civile në lehtësimin e implementimit të këtij procesi. Në këtë tryezë të rrumbullakët morën pjesë rreth 30 pjesëmarrës në mesin e të cilëve përfaqësues institucioneve lokale, nga Zyra Civile Ndërkombëtare, përfaqësues të OJQ-ve dhe medieve.

Besnik Tahiri nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale deklaroi se procesi i decentralizimit në fillim nuk kishte mbështetje nga komunitetet në Kosovë, ngaqë nuk ishte shpjeguar si duhet. *“Me krijimin e komunave të reja është rritur bashkëpunimi me komunat amë, mirëpo gabimi fillestar ishte që ky proces u karakterizua si i pastër politik dhe nuk iu dha ngjyrimi i nevojshëm, se procesi i decentralizimit është në funksion të ofrimit të shërbimeve më efikase dhe më cilësore për qytetarët”*, duke shtuar se *“prezenca e strukturave paralele në këto komuna është reduktuar vetëm në ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore dhe mësimdhënien bazuar në planprogramet arsimore paralele, gjë për të cilët duhet të punojë Qeveria e Kosovës dhe të ofrojë alternativën e saj”*. Sipas Tahirit procesi i decentralizimit, respektivisht krijimi i komunave të reja të Ranillugut/Ranilug, Klokotit-Verbovc/Klokot-Verbovac dhe Graçanicës/Gračanica, është përcjellë edhe me legjitimitet të plotë qytetar. *“Dalja në zgjedhjet e para lokale në këto komuna ka shënuar rritje prej 100%, krahasuar me zgjedhjet lokale të mbajtura në komunat amë para krijimit të këtyre komunave”*, shtoi në fund të prezantimit tij Tahiri.

Besim Hoti, zëdhënës i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, duke folur për sfidat e sigurisë tha se strukturat paralele nxisin ndjenjën e pasigurisë dhe frikës tek qytetarët në veri të Kosovës si dhe krimi i organizuar shfrytëzon gjithë vakumin ligjor të merret me çështje të kundërligjshme. *“Mungesa e institucioneve të drejtësisë, prokurorisë dhe gjykatave bën që puna e policisë, në kapjen e kryerësve të krimeve të të gjitha natyrave, të zbehet për shkak se ato nuk janë funksionale dhe qytetarët në momentin kur i shohin këta persona në liri humbin guximin për bashkëpunim me organet e rendit dhe sigurisë”*, shtoi në fund Hoti.

Drejtoresha e CivilKos-it, znj. Valdete Idrizi, theksoi nevojën e bashkëpunimit të Institucioneve me shoqërinë civile në procesin e implementimit të decentralizimit, duke shtuar: “*institucionet duhet të shohin shoqërinë civile si aleat*”.

Gazetari dhe analisti politik nga Mitrovica, Nexhmedin Spahiu, duke folur për rolin e OJQ-ve dhe mediave tha se Qeveria e Kosovës duhet të dërgojë sinjale pozitive për funksionimin e organeve shtetërore në gjithë Kosovën, në mënyrë që komunitetet të ndihen të sigurta në momentin kur ky proces fillon të implementohet.

Duhet të ketë më shumë demokraci në nivel të vendit që të binden komunitetet në Veri se do të marrin demokraci, duhet të ketë sundim të ligjit, zhvillim ekonomik dhe liri të shprehjes së lirë në mënyrë që të kuptohet mesazhi se këto të mira do t'i presin edhe këto komunitete në momentin kur decentralizimi do të jetësohet edhe në këtë pjesë të Kosovës.

Pjesëmarrësit në fund të takimit nxorën këto rekomandime të nevojshme për institucionet vendore dhe ndërkombëtare në mënyrë që procesi i decentralizimit në veri të Mitrovicës të jetësohet:

1. Nevoja e përkushtimit dhe vullnetit politik nga ana e institucioneve relevante vendore dhe ndërkombëtare në zbatimin e procesit të decentralizimit
2. Strategjia për integrimin e veriut dhe funksionalizimi i Zyrës administrative në veri të Kosovës
3. Funksionalizimi i plotë i gjykatave dhe prokurorive në veri të Kosovës
4. Sensibilizimi më i madh i qytetarëve të Kosovës në lidhje me karakterin e vërtetë të procesit të decentralizimit
5. Ofrimi i shërbimeve efikase dhe cilësore për të gjithë qytetarët e veriut të Mitrovicës
6. Rol më gjithëpërfshirës i OJQ-ve dhe mediave në procesin e decentralizimit dhe krijimi i hapësirës së nevojshme për veprim nga ana e Qeverisë së Kosovës
7. Dërgimi i sinjaleve të qarta drejt qytetarëve të kësaj pjese të Kosovës se jeta e tyre do të përmirësohet duke parë shembujt pozitivë të zhvillimit në anët tjera të Kosovës
8. Mospërsëritja e gabimeve të bëra në komunat tjera, të krijuara nga procesi i decentralizimit, si dhe marrja për bazë e shembujve të rasteve të suksesshme.

Mitrovicë/Mitrovica, 05 korrik 2012